



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, mbledhur në datë 14.11.2022, ora 12:00, në prezencë të anëtarëve të tij, në mbështetje të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat”, duke zhvilluar mbledhjen sipas rendit të ditës,

KONSTATOI:

Dhoma Kombëtare e Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, pasi administroi urdhrin nr. 406, datë 24.8.2022 të ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e numrit të vendeve për kandidat përmbardues që do të pranohen në Programin e Trajnimit Fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbarduesve për vitin 2022”, në datën 10.10.2022, vendosi për:

- Miratimin e Thirrjes për Shprehje Interesi për hyrjen në provimin e pranimit në trajnimin fillestar, duke përcaktuar datën, orën dhe vendin e zhvillimit të provimit të pranimit në formimin fillestar.
- Kjo Thirrje u përcoll për shpallje në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, përmes shkresë nr. 971 prot., datë 10.10.2022.
- Kjo thirrje u publikua për të paktën për dy javë rresht në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare dhe me shkresën me nr. 972 prot., datë 10.10.2022, iu kërkua zyrtarisht Ministrisë së Drejtësisë publikimi i thirrjes dhe në faqen e tyre zyrtare.
- Ky vendim u vendos të bëhet menjëherë publik në respektim të afatit 3 (tre)-muor përpara datës së caktuar të provimit, në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare, ku dhe t`i kërkohet zyrtarisht Ministrisë së Drejtësisë publikimi edhe i këtij vendimi në faqen e tyre zyrtare.

Deri në datën 14.11.2022, rezulton se Ministria e Drejtësisë, ende nuk e ka publikuar Thirrjen në faqen e saj zyrtare, pavarësisht se njoftimi u përcoll për shpallje përmes shkresës nr. 972 prot., datë 10.10.2022. Ky fakt, ka ndikuar ndjeshëm në uljen e vizibilitetit të thirrjes, çka është reflektuar në numrin e ulët të aplikantëve për të marrë pjesë në provim.

Në këto kushte vlerësohet se jo vetëm vizibiliteti më i lartë i thirrjes është thelbësor për të garantuar një numër të madh kandidatësh që aplikojnë për pjesëmarrje në provim, duke rritur mundësitë e përthithjes së atyre kandidatëve sa më cilësorë, porse dhe publikimi i thirrjes edhe nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, është me rëndësi sipas akteve nënligjore në fuqi.

Për sa më sipër, Këshilli Drejtues, me shumicën e votave të anëtarëve të tij,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit deri në datën 15.12.2022, për dorëzimin e shprehjeve të interesit nga ana e kandidatëve që duan të aplikojnë për hyrjen në provimin e pranimit në trajnimin fillestar.

2. Përsëritjen e publikimit të Thirrjes, me afatin e ri për dorëzimin e shprehjeve të interesit, duke e përcjellë për shpallje në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
3. Kjo thirrje të publikohet të paktën për dy javë rresht në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare, në rrjetet sociale në përdorim të Dhomës Kombëtare, si dhe t'i rikërkohet zyrtarisht Ministrisë së Drejtësisë publikimi i thirrjes në faqen zyrtare të institucionit, si dhe në çdo mjet tjetër komunikimi masiv në përdorim të Ministrisë së Drejtësisë, për të rritur vizibilitetin e Thirrjes.
4. Kostot e planifikimit, zhvillimit dhe nxjerrjes së rezultateve të provimit do të përballohen nga buxheti i Dhomës Kombëtare dhe nga tarifat e mbledhura për përpunimin e dokumentacionit nga secili aplikant.
5. Kosto e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga të interesuarit do të përfshijnë kryerjen e pagesës së tarifës së përpunimit të dokumentacionit, në masën 10 000 lekë për çdo kandidat që aplikon për pjesëmarrje në provim.
6. T'i propozohet ministrit të Drejtësisë, përcaktimi i masës së shpërblimit të anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit për organizimin e provimit të pranimit në trajnimin fillestar dhe e sekretarit që do ta asistojë, në vlerën 10 000 lekë për mbledhje, shumë kjo që do përballohet nga Buxheti i Dhomës, sipas akteve nënligjore në fuqi.
7. Të informohen aplikantët mbi tarifën e ndjekjes së Programit të plotë të Trajnimit Fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbaruesve, që është në masën 300 000 lekë. Kjo tarifë do të paguhet nga kandidatët e shpallur fitues për të ndjekur programin e detyrueshëm 1-vjeçar për trajnimin fillestar pranë Qendrës së Trajnimit, brenda 10 ditëve nga publikimi i rezultateve të provimit.
8. Komunikimet e nevojshme institucionale me qëllim organizimin dhe zhvillimin e provimit, të mbahen nga Kryetari i Dhomës, i cili mban detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbaruesve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES

Z. Alban RULI

Znj. Najada BEQARAJ

Z. Admir BEQIRI

Z. Ilia ELEZI

Z. Fabio ISUFAJ

Z. Bislim SINAJ